

Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”

THIRRJE PËR APLIKIM

për Institucionet Arsimore të sistemit të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë që do të jenë pjesë e projektit
“Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”
për vitin shkollor 2020-2021

1. Konteksti

Projekti “**Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri**” zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Projekti do të zbatohet për një periudhë katërvjeçare. Në përputhje me instrumentet dhe qasjet e Këshillit të Evropës, projekti synon të përmirësojë cilësinë e arsimit parauniversitar në Shqipëri, duke forcuar kapacitetet e sistemit arsimor që zhvillojnë kompetencat e nxënësve për kulturë demokratike.

Projekti do të përkrahë reformën aktuale të kurrikulave shkollore, bazuar në *kompetenca* dhe qasjet e reja të arsimit që ato përfshijnë, si dhe metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin.

Përgjatë tre viteve projekti do të mbështesë 75 shkolla pilot të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (ndarë në tre cikle, 25 shkolla të përzgjedhura për secilin vit), për të zhvilluar dhe zbatuar kulturën demokratike, politikat dhe praktikën për qeverisje demokratike në shkollë, me synimin për të krijuar një mjedis nxënës e gjithëpërfshirës dhe për të gjithë nxënësit. Secili nga tre ciklet do të zhvillohet gjatë një viti shkollor. Përpara çdo cikli do të kryhet një skemë e granteve të vogla për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), dhe 5 Organizata të Shoqërisë Civile do të marrin mbështetje financiare të cilën ato do ta përdorin për të punuar në shkolla dhe për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të propozuara dhe udhëhequra nga vetë nxënësit në shkollat dhe komunitetet e tyre. Çdo vit, shkollave do t’u ofrohet një temë e ndryshme që lidhet me aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe njohuritë e Kuadrit të Kompetencave për Kulturë Demokratike.

Për vitin mësimor 2020-2021, tema e përzgjedhur është “**Si ta bëjmë shkollën një mjedis më të sigurtë mësimi**”.

Do të krijohet një rrjet shkollash demokratike që do të shërbejnë si bashkësi dhe do të ofrojnë platforma praktike për përhapjen e modeleve më të mira shkollore në mbarë vendin. Nxënësit, mësuesit dhe stafi drejtues i shkollës do të kenë mundësi të marrin pjesë në veprimtaritë e shkëmbimeve të përvojave (*peer learning*), aktivitetet ndërgjegjëse, shkollat verore dhe rrjetet e punës.

Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, do të dakordësojnë bashkërisht përzgjedhjen e 25 shkollave të para pilot në Shqipëri, duke mbajtur parasysh kriteret e përcaktuara të përzgjedhjes.

Shkollat e interesuara, për të qenë pjesë e projektit, duhet të plotësojnë **Formularin e Aplikimit**, pjesë përbërëse e kësaj thirrjeje, dhe të dërgojnë dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

Krahas Formularit të Aplikimit, duhet të bashkëlidhen dhe dokumentet e mëposhtme:

1. Plani i Zhvillimit ose Plani i Veprimit të shkollës;
2. Letër mbështetjeje nga Bordi i Shkollës, për pjesëmarrjen e shkollës në projekt.

Formulari i aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqërues, duke përfshirë edhe dokumentet që dëshmojnë praktikën e mira në shkollë, duhet të dërgohen **brenda datës 31 korrik 2020**, në adresën e emailit education.tirana@coe.int.